



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:030447

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06493126

**2024:030448**  
**( Nr. vjetër P.nr. 1559/18)**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.D. nga Romania ....., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.2386-10/18, të dt.21.11.2018, konform neneve 106 par 1 pika 1.5 dhe nenit 107 par. 8 të KPRK-së, si dhe nenit 248 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, me dt.15.11.2024 mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**Hudhët aktakuza** e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 2386-10/18, e dt.21.11.2018, ndaj të pandehurit G. M. D., i lindur më dt..... në Mun. . sec..., me vendbanim në Romania ..... nr. 3.. nr. Personal ....., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe pushohet procedura penale për shkak të **parashkrimit absolut** të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 2386-10/18, të dt.21.11.2018, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të veprës penale, Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Nga dispozitivi i aktakuzës rezulton se vepra penale është kryer më datë 10.11.2018 dhe për këtë veprë penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim deri 3 (tri) vite.

Në nenin 106 par.1 pikë 5 të KPPK-së, parashihet se ndjekja penale për vepra penale të dënueshme deri 3 (tri) vite burgim, nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati prej 3 /tri/ viteve nga data e kryerjes së veprës penale-parashkrimi relativ, e në rastin konkret janë ndërmarr disa veprime me të cilat është ndërpre parashkrimi relativ, mirëpo deri më datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi tani kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite dhe për këtë ka arritur parashkrimi absolut dhe rrjedhimisht ndjekja penale më nuk mund të ndërmerret për shkak se ka ndodhur parashkrimi absolut i kësaj vepre penale.

Në nenit 107 pika. 8 të KPPK-së, thuhet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale) e që në rastin konkret data e kryerjes së veprës penale është 12.05.2016, e që në këtë rast është vërtetuar se kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë ) vite, e që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut dhe më nuk mund të bëhet ndjekja penale.

Konform nenit 453 par.1 të KPPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**2024:030448, ( Nr. vjetër P.nr. 1559/18), me datë 15.11.2024**

Zyrtare ligjore  
Kimete Bytyqi

Gjyqtari:  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tri/ ditëve nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.